

VENDIM
Nr. 131, datë 15.8.2016

MBI NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË SHPALLUR NGA SHOQËRIA KESH SHA
“FTESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR MARRËVESHJEN KUADËR PËR
DEPOZITIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a. “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në faqen zyrtare të KESH sh.a., është publikuar ftesa për shprehje interesi për “Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.

- Subjektet GEN-I Tirana sh.p.k., AXPO Trading AG dhe AAES kanë dërguar ankimet e tyre në ERE, me shkresat respektive nr. 490/4 prot., datë 8.7.2016, nr. 490/8 prot., datë 26.7.2016 dhe nr. 13 prot., datë 29.6.2016.

- KESH sh.a., në datën 20.7.2016, nëpërmjet shkresës nr. 5960/1 prot., i ka bërë me dije subjekteve si më sipër se: “Ky produkt i prezantuar nga KESH sh.a. nuk është subjekt i rregullimit nga “Rregullat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike”, të miratuar nga ERE. KESH sh.a. funksionon si një shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror bazuar në përcaktimet e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

- I licencuari KESH sh.a., është një person juridik i pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009, i cili zbaton legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe detyrimet e shërbimit publik, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ushtron aktivitet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Është konstatuar se KESH sh.a. nuk ka respektuar dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili parashikon si transaksione të energjisë elektrike, blerjen, shitjen dhe shkëmbimin.

- KESH sh.a. nuk ka respektuar parashikimet e “Rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 100, datë 27.12.2006.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a. të ndërpresë menjëherë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin e procedurës së shpallur “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.

2. KESH sh.a. të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit, njoftimin për ndërprerjen e procedurës ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, Autoritetin e Konku-rrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti